



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/13

Datë: 27.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2008, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti i mbledhjes së 12 të Qeverisë së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/13

Datë: 27.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2008, mori

V E N D I M

1. Lejohet nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit në mes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllim të rregullimit të çështjes së punëtorëve të cilët nuk mund të përfshihen në listë të rregullt të pagave.
2. Të dy ministratë, sipas pikës 1 të vendimit, obligohen që të harmonizojnë veprimet lidhur me këtë çështje.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/13
Datë: 27.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2008, mori

V E N D I M

1. Punonjësve të personelit akademik/mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës që kanë mbushur moshën 65 vjeçare, pasi të ketë filluar viti shkollor, iu vazhdohet kontrata e punës deri në përfundimin e vitit akademik.
2. Obligohet Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/13

Datë: 27.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2008, mori

V E N D I M

1. Të caktohen anëtarët për Grupin punues ndërministror kundër korrupsionit nga të gjitha ministrinë përkatëse.
2. Obligohet Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM që, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, të koordinojë punët lidhur me plotësimin e grupit punues.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/13
Datë: 27.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2008, mori


V E N D I M

1. Në të gjitha institucionet e arsimit para-universitar të Kosovës të fillojë procesi i gradimit dhe i licencimit të mësimdhënësve.
2. Procesit të gradimit dhe të licencimit do t'i nënshtrohen të gjithë mësimdhënësit e institucioneve të arsimit para-universitar të cilët do të përfitojnë shtesa në pagë dhe përparim në karricë nga ky proces.
3. Procesi i gradimit dhe i licencimit nënkupton:
 - a) Gradimi - përcaktimi i pozicionit dhe rritjes së pagës sipas shkallës së kualifikimit dhe përvojës në punë, të mësimdhënësit.
 - b) Licencimi - dhënia e lejes për të ushtruar profesionin e mësimdhënies e cila bazohet në performancë.
4. Ngarkohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të themelojë struktura përkatëse si dhe të hartojë procedurat e nevojshme për realizimin e gradimit dhe të licencimit të mësimdhënësve.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

5. Të themelohet një komision ndërministror me pjesëmarrje nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga Zyra e Kryeministrit dhe nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave për të përcaktuar efektet financiare të procesit dhe masat për zbatimin e vendimit.
6. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/13
Datë: 27.03.2008

Në mbështetje të nenit 9.3.16. të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9, mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë dhe të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, si dhe të nenit 4, pika 3 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 mars 2008, mori

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Qeveritar për përcaktimin e vijës së demarkacionit në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë.
2. Komisioni do të jetë në përbërje prej pesë anëtarëve:
 1. Bekim Çollaku (kryesues)
 2. Xhafer Tahiri (anëtar)
 3. Behar Selimi (anëtar)
 4. Murat Meha (anëtar)
 5. Asllan Pushka (anëtar)
3. Të gjitha shpenzimet për funksionimin e këtij komisioni mbulohen nga fondi rezervë i Ministrit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

4. Të gjitha Institucionet e Republikës së Kosovës janë të obliguara që Komisionit t'i ofrojnë shërbimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që të bashkërendojë të gjitha aktivitetet që dalin nga zbatimi i këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë